



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr.1023/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbarimore të kreditorit “H... Sh.P.K., me numër unik identifikues ....dhe seli në ... , Komuna e Ferizaj, kundër debitorit “A...” Sh.P.K., me numër unik identifikues ... dhe seli në Prishtinë, rr. “...” duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 326/21, i lejuar me datë 16.03.2021, nga Përmbaruesi Privat Valdrin Beka, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 28.04.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “A...” Sh.P.K., me numër unik identifikues ... , ashtu që Urdhri Përmbarimor P.nr. 326/21, i lejuar me datë 16.03.2021, nga Përmbaruesi Privat Valdrin Beka, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën faturës nr. FDV20-9-001317, e datës 29.02.2020, faturës nr. FDV20-9-002577, e datës 31.03.2020, faturës nr. FDV20-9-003357, e datës 30.04.2020, si dhe faturës nr. FDV20-9-004499, e datës 31.07.2020, ka lejuar urdhrin për përmbarim P.nr. 326/21, me datë 16.03.2021, me të cilin është detyruar debitori, që në emër të përmbarimit të obligimeve nga faturat si më sipër, brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin, t’ia paguaj kreditorit shumën prej EUR 9,799.58, me kamatëvonesë prej 8% në vit, duke llogaritur nga data kur kërkesa është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori, në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor, me arsyetim se urdhri është i bazuara në fatura të cilat janë në kundërshtim me dispozitat ligjore, konkretisht nuk janë në përputhje me nenin 37 të LPP-së, me të cilin parashihet se dokumenti i besueshëm duhet të jetë në origjinal apo kopje të noterizuara. Tutje, ka shtuar se faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri për përmbarim nuk përmbajnë vulë të pranimit nga debitori e as nënshkrimin e tij, e poashtu faturat nuk përmbajnë afat për shlyerje eventuale të detyrimit sikurse ti kishte pranuar debitori. Gjykatës, i ka propozuar që ta aprovoj në tërësi si të bazuar prapësimin, dhe urdhri përmbarimor të shfuqizohet.

Kreditori, brenda afatit ka paraqitur përgjigje në prapësim, përmes së cilës e ka deklaruar se prapësimi i debitorit është tërësisht i pabazuar. Ka theksuar se pretendimet e debitorit se faturat nuk i janë dorëzuar asnjëherë dhe se nuk mbajnë nënshkrimin apo vulën e pranimit, është i pabazuar ngase në asnjë dispozitë nuk kërkohet që fatura të jenë të nënshkruara dhe të vulosura nga debitori për tu cilësuar si dokument i besueshëm, mirëpo vetëm kërkohet që të përmbajnë elementet tjera ligjore. Tutje, ka shtuar se me debitorin kanë arritur marrëveshje me datë 27.12.2018 dhe kanë nënshkruar kontratën e shitblerjes së derivateve, përmes së cilës janë pajtuar që faturat do të dorëzohen fizikisht apo në mënyrë elektronike në email adresën e debitorit, andaj kreditori sipas marrëveshjes faturat ia ka dorëzuar duke u bazuar në kontratë. Poashtu, ka theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit se faturat janë në kundërshtim me nenin 27 të LPP-së, ngase të njëjtat janë paraqitur në origjinale dhe se i përmbajnë elementet e kërkuara ligjore, ndërsa debitori nuk ka ofruar asnjë provë për ti mbështetur pretendimet e tij siç përcaktohet me nenin 69.4 të LPP-së. Në fund, ka theksuar se faturat janë në përputhje të plotë me dispozitat nga Ligji për tatimin mbi vlerën e shtuar. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit, ashtu që urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi, si dhe të obligohet debitori të paguaj shpenzimet në emër të përpilimit të kësaj përgjigje në prapësim, sipas tarifave të parapara.

Gjykata, ka shqyrtuar pretendimet e palëve, si dhe provat të cilat gjenden në shkresa të lëndës, dhe në kuptim të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (në tekstin e mëtejshëm “LPP”), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet, për shkak të vijimit:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 të LPP-së, *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa, në pikën 1.3 të të njëjtit nen, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të nenit 29 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*. Në anën tjetër, neni 37 i LPP-së, përcakton se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata gjeti se faturat mbi bazën e së cilave është lejuar propozimi për përmbarim nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme. Kjo për arsye se, nga shkresat e lëndës nuk rezulton se këto fatura janë pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, përkatësisht kreditori nuk ka ofruar ndonjë provë me të cilën dëshmohet se faturat i janë dorëzuar me rregull debitorit dhe se i njëjti i ka pranuar dhe se është njoftuar me detyrimin që rrjedh nga të njëjtat.

Gjykata pati parasysh pretendimet e kreditorit lidhur me dorëzimin e faturave përmes email në adresën elektronike të debitorit, mirëpo, në mungesë të konfirmimit të pranimit të email me përmbajtje të faturave mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri, dorëzim i tillë për gjykatën nuk mund të konsiderohet si i rregullt, dhe rrjedhimisht nuk nënkupton pranim të rregullt të faturave nga ana e debitorit.

Andaj, meqë në shkresa të lëndës nuk ka prova se debitori ka pranuar faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri, dhe se nuk ka konfirmim nga debitori për pranimin e faturës përmes email, atëherë faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri, si të tilla, rezultojnë se janë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit, dhe rrjedhimisht nuk janë të përshtatshme për përmbarim.

Nisur nga një gjendje e tillë, gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit përmbaruesi privat ka

lejuar përmbarimin, nuk ka tipare të përmbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të anulohet.

Nga sa më sipër, gjykata në kuptim të nenit 71 paragrafi 1, pika 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1023/22, datë 28.04.2023

Gjyqtari

Arbër Rexha

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.